

Gjykata Themelore Gjilan – Dega në Kamenicë, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, përmes gjyqtarit Burim Shala, me sekretarin juridik Ardian Sermaxhaj, në çështjen kontestimore të paditësit I.C. nga, fsh... komuna e Kamenicës, të cilin me autorizim e përfaqëson M.M. kundër të paditurve R.C.1 dhe R.C. 2, që të dy nga fsh... komuna e Kamenicës, të cilët me autorizim i përfaqëson E.C. nga ... për shkak të pengimit të posedimit, vlera e kontestit 3.300.00 Euro, pas mbajtjes së seancës mbi shqyrtimin kryesor më datën 31.07.2015 mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar kërkesë-padia e paditësit I.C. nga fsh..., me të cilën ka kërkuar që të Vërtetohet se të paditurit R.C.1 dhe R.C.2, që të dy nga fsh... kanë penguar paditësin I.C. nga fsh..., në atë mënyrë që më datën 02.12.2014, në orët e paradites nuk e kanë lejuar paditësin të shërbehet nëpër rrugën e cila udhëhiqet si parcelë kadastrale nr.2686 në v.q. “Batllak”, për z.k. ..., e cila është rrugë e përbashkët dhe të cilën e ka shfrytëzuar me tepër se 20 vite pa qenë i penguar nga askush, duke i thënë se nuk ke të drejtë ta shfrytëzosh këtë rrugë dhe të urdhërohen të paditurit R.C. nga fsh..., që ta lejojnë paditësin ta shfrytëzojnë këtë rrugë me që duhet të bartë material ndërtimor për përfundimin e objektit të tij sapo ndërtuar për kryerjen edhe të punëve finale dhe të përmbahet që në të ardhmen të mos e pengojnë paditësin, në këtë apo mënyrë të ngjashme, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

II. Obligohet paditësi I.C. nga fsh..., që të paditurve t’ia paguajë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 808.00 Euro si dhe kësaj gjykate në emër të taksës për vendim ti paguaj shumën prej 25 Euro në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi me kanosje përmbarrimi.

A r s y e t i m

Paditësi I.C. nga fsh..., komuna e Kamenicës, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij M.M.avokat nga ..., më datën 19.12.2014 ka paraqitur padi në këtë gjykatë për shkak të pengimit të posedimit, kundër të paditurve R.C.1 dhe R.C.2, që të dy nga fsh..., Komuna e Kamenicës, të cilët me autorizim i përfaqëson E.C. avokat nga

I autorizuari i paditësit, av.M.M, si në padi, po ashtu edhe në seanca për shqyrtim kryesor ka mbetur në tërësi pranë kërkesë padisë, duke shtuar se paditësi është pronar dhe posedues i ngastrës kadastrale nr.2685 në v.q. “Batllak”, për z.k. ..., ai në këtë ngastër e ka ndërtuar një garazhë dhe i ka përfunduar punimet e vrazhda, punimet e vrazhda kanë zgjatur shtatë javë dhe për këtë kohë paditësi nuk është penguar nga askush sikundër rrugën kontestuese e ka

shfrytëzuar prej 20 viteve pa u penguar nga të paditurit apo ndonjë person tjetër, ajo është e vetmja rrugë dhe rrugë tjetër nuk ka, i ka propozuar gjykatës që e njëjta të bëjë këqyrjen e vendit të ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë, e po ashtu të dëgjohen edhe dëshmitarët M.B. B.R. dhe A.C., ndërkaq në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga provat e shtjelluara dhe faktet e vërtetuar është vërtetuar se të padituri kanë kryer aktin e pengim posedimit ndaj paditësit, ashtu që më 2 dhjetor të vitit 2014 e kanë penguar paditësin në posedim dhe kalim me këmbë dhe veturë nëpër rrugë. Nga deklarata e dëshmitarit M.C. është vërtetuar se rruga ka ekzistuar dhe nëpër të njëjtën rrugë është shërbyer paditësi me këmbë dhe veturë dhe në fund të rrugës ekziston rrethoja me tel e cila kufizohet me ngastrën e paditësit nga deklarata e të paditurit R.C. vërtetohet se dryni për hapjen e portës dhe kodit të të njëjtit dry ia ka dhënë paditësit, djali i të paditurit R., B. Në ngastrën e tij paditësi ka punuar një objekt për disa javë me një gabarit tejet të madhë, janë kryer punët e vrazhda, është qitur pllaka prej betoni dhe rrymën e ujin paditësi i ka përdorur nga shtëpia e të paditurit dhe se materiali është bartur nëpër këtë rrugë kontestuese dhe nuk ka pasur asnjë reagim deri në javën e tetë të punimeve, këtë fakt e vërteton edhe deklarata e dëshmitarit M.B., i cili ka qenë kryes i punëve në pronën e paditësit, sa i përket deklaratës së S.C., i propozoj gjykatës që asaj të mos i shprehë besimin, ngase dëshmia e tij nuk është objektive, ngase ai merrë pagë prej të paditurve, pasi që ia mbikëqyrë shtëpitë të njëjtëve, në fund i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia të aprovohet në tërësi si e bazuar dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës për përpilimin e padisë shumë prej 104 Euro, taksën për padi shumë prej 100 Euro, për tri seanca të mbajtura shumë prej nga 135 Euro për seancë dhe për një seancë të shtyrë shumë prej 67 Euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i të paditurve, E.C., si në përgjigje në padi, ashtu edhe në seancat për shqyrtim kryesor e ka kontestuar në tërësi kërkesë padinë dhe ka theksuar se kërkesë padia e paditësit është e pathemeltë, është e vërtetë se paditësi është pronar i ngastrës kadastrale 2685, por kjo ngastrë është arë ndërkaq tani rruga ku pretendohet prej paditësit se është penguar nga të paditurit është e regjistruar në emër të të paditurve dhe ata e kanë të drejtën e pronësisë mbi rrugën por edhe mbi trojet, atë e kanë fituar mbi bazë të kontratës mbi faljen prej babait të tyre, nuk qëndrojnë pretendimet se rrugën paditësi e ka shfrytëzuar që 20 vite, pasi që të paditurit të drejtën e pronësisë e kanë fituar vetëm në vitin 2002, të paditurit kanë të ndërtuar shtëpitë, dyert e hyrjes së rrugës i kanë vendosur të paditurit bile në fund të rrugës ka qenë një tel i cili ka kufizuar oborrin e të paditurve me arën e paditësit ku ai e ka ndërtuar garazhën duke e shfrytëzuar mungesën e të paditurve, pasi që kur është ndërtuar garazha ata kanë qenë në Zvicër, e jo në Kosovë dhe nuk kanë pasur njohuri për këtë çështje dhe kur kanë mësuar për atë fakt ata nuk e kanë lënë që të kalojë paditësi nëpër këtë rrugë, ngase ai paditësi nuk ka qenë fare në posedim të saj, se për fitimin e posedimit apo edhe të pronësisë duhen të ekzistojnë disa baza e në rastin konkret ato baza i mungojnë paditësit, rrugën kontestuese të paditurit vet e kanë shtruar me kubëza të betonit gjatë tërë gjatësisë dhe tërë gjerësisë, i ka propozuar gjykatës që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen M.C., S.B., S.C. dhe në cilësi të palës të dëgjohet i padituri R.C., në fjalën përfundimtare ka theksuar se sipas Ligjit mbi të Drejtat Sendore dhe Pronësinë posedimi fitohet nga poseduesi me mirëbesim dhe të jetë i ndërgjegjshëm poseduesi dhe jo ta shfrytëzoj

mungesën e poseduesve dhe të kërkojnë numrin e kodit nga djali ti të paditurit R., i cili nuk ka qenë në posedim të asnjërës ngastër, pastaj hapja me dhunë e drynit të dyerve dhe rrënimi i rrethojës së telit në pjesën përfundimtare të rrugës nuk janë elemente për shkak të cilave fitohet posedimi, të dy të paditurit këto ngastra i kanë blerë në vitin 1992, në gjykatë kanë vërtetuar kontratat, deri në muajin e nëntor të vitit 2014 paditësi nuk ka kërkuar rrugë gjegjësisht të drejtë kalimi nëpër rrugën kontestuese dhe të gjitha faktet tregojnë se paditësi nuk ka kaluar nëpër oborrin e të paditurve, por ai ka kaluar nëpër ara tjera për ta shfrytëzuar arën e tij, sa i përket dëshmitarit M.C., të cilin ne e kemi propozuar deri në ditën e djeshme i ka thënë palëve ndërgjyqësore se nuk di asgjë lidhur me këtë çështje ndërsa pse e ka ndërruar deklaratën në ditën e sotme ne nuk mund ta dimë, i ka propozuar gjykatës që kërkesë padia të refuzohet si e pa bazuar ndërkaq i ka kërkuar shpenzimet sipas listës së shpenzimeve të dorëzuar me shkrim me datë 31.07.2015 në ora 11:56 minuta.

Gjykata pas dëgjimit të palëve përkatësisht të autorizuarve të tyre ka administruar provat e propozuara prej tyre si, në cilësi të dëshmitarëve ka dëgjuar dëshmitarët A.C., M.B., B.R., M.C., S.B., S.C., si dhe në cilësi të palës ka dëgjuar të paditurin R.C., ka bërë këqyrjen e vendit të ngjarjes së bashku me ekspertin e gjeodezisë N.R., si dhe ka lexuar provat materiale çertifikatën mbi të drejtat e pronës së paluajtshme P-71107040-02685-0, çertifikatën nr.3033/2014, çertifikatën nr.3034/14, skicën e terrenit punuar nga eksperti i gjeodezisë N.R. dhe kontratat mbi faljen e paluajtshmerisë nr.VR.433/2002, dhe nr.VR. 310/2002, e pas administrimit të këtyre provave një nga një e të tërave bashkërisht gjykata ka vërtetuar gjendjen faktike prej nga ka gjetur se kërkesë padia e paditësit Ismet Canaj është e pa bazuar.

Në këtë çështje juridike me bazë kontesti pengim i posedimit mes palëve ndërgjyqësore nuk kanë qenë kontestuese faktet se paditësi është pronar dhe poseduese i ngastrës kadastrale nr.2685, në v.q. “Batllaka”, z.k.... ndërkaq të paditurit janë pronar të ngastrës kadastrale nr.2686-3 në v.q. “Batllaka”, dhe atë si bashkëpronar $\frac{1}{2}$ të pjesëve të saj, po ashtu kontestuese nuk ka qenë as fakti se në ngastrën e tij paditësi ka ndërtuar një garazhë me material të fortë betoni dhe Blloka të Kuqë.

Në këtë çështje juridike mes palëve kontestues ka qenë fakti se paditësi I.C., a ka qenë në posedim të një pjesë të ngastrës kadastrale 2686, e cila është rrugë dhe a ka kaluar ai nëpër atë rrugë për të shkuar tek ngastra e tij, a ka të drejtë ai që të kalojë nëpër këtë rrugë dhe a e kanë penguar paditësin gjegjësisht nuk e kanë lejuar që të kalojnë nëpër këtë rrugë, pra këto kanë qenë fakte kontestuese mes palëve ndërgjyqësore.

Nga këqyrja në vendin e ngjarjes gjykata ka konstatuar se rruga faktike është njësi kadastrale që ka numrin 02686/3, në v.q. “Batllaka”, me gjatësi prej 104.50 metra dhe gjerësi 3 metra, e njëjta shtrihet në drejtim lindje - perëndim dhe fillon me hyrje prej rrugës kryesore tek trotuari i rrugës regjionale, rruga përfundon tek fundi i shtëpisë së të paditurit të parë R.C., gjegjësisht ngastra kadastrale e paditësit me nr.2685, rruga ka qenë e shtruar me kubëza betoni në pjesën më të madhe të saj, me përjashtim në fund të rrugës, kah ana perëndimore është e

shtruar me zhavor të përzier me një gjatësi rreth 15 metra kah pjesa jugore, rruga është e rrethuar me tel rretë katrore, me lartësi prej 1.5 metra me shtylla të metalta, kah ana veriore e rrugës gjinden shtëpitë e të paditurve dhe atë në fillim të rrugës gjendet shtëpia dhe trualli i të paditurit R.C. ndërkaq më poshtë shtëpia e të paditurit R.C., në fund të rrugës gjegjësisht në pjesën fundore ka qenë i vendosur teli rrethues me shtylla të metalta dhe i çimentuar në tokë me beton, mirëpo i larguar prej paditësit dhe tani ai është i pa përfunduar, në hyrje të rrugës kah ana veriore gjenden dyert e metalta në lartësi prej 1.7 metra, janë funksionale, kanë bravën e dyerve dhe drynin.

Nga skica e terrenit punuar nga eksperti i gjeodezisë N.R., gjykata ka vërtetuar faktin se ngastra kadastrale e paditësit ka numrin 2685, ndërkaq ngastra kadastrale e të paditurit R.C.1, ka numrin 2686/2, ndërkaq e të paditurit R.C.2, 2686/1, ndërkaq rruga tani kontestuese ku kërkohet mbrojtje gjyqësore nga akti i pengimit të posedimit, ka numrin 2686/3 dhe evidentohet në emër të të paditurve si bashkëpronar, pra rruga është e regjistruar me numër të veçantë dhe atë si rrugë.

Dëshmitari A.C., në seancën për shqyrtim kryesor ka deklaruar se axhallarët e mi R.1 dhe R.2, po e pengojnë babain tim që ai të kalojë nëpër këtë rrugë që është tani në gjendjen faktike si rrugë e që ka shërbyer që 20 vite si rrugë, deri kur i kanë paraqitur kundërshtimet e fundit axhallarët e mi, kur e ka blerë këtë ngastër babai im, ka menduar se ka rrugë nëpër truallin e axhallarëve, ngase rrugën gjithherë e kemi shfrytëzuar nëpër truallin e tyre dhe kemi filluar ndërtimin në ngastër të një objekti një katesh apo përdhësë i cili ka përfunduar me punë të vrazhda me destinacion garazhë, ne punët i kemi filluar në javën e parë të muajit tetor të vitit 2014, dhe rrymën e ujin i kemi marrë prej axhës R. pasi që ai e ka shtëpinë afër garazhës së filluar, unë kam biseduar personalisht me axhën R. dhe ai më ka thënë urime që ke filluar të punosh dhe mund ta shfrytëzosh ujin dhe rrymën prej shtëpisë sime, mirëpo ka ardhur një momenti i caktuar ku ai na ka thënë se nuk keni rrugë, dyert e rrugës kanë qenë të mbyllura me dry të biçikletës dhe kodin e kanë pasur viti 1987, vit i lindjes së djalit të axhës, B., mirëpo pas ngritjes së padisë axhallarët e mi, kanë ndërruar drynin e dyerve, tani dryni nuk është me kod por me çelës, pas kësaj kohe në garazhë nuk kemi mundur të punojmë më, dyert në hyrje të rrugës që janë nga metali i kanë rregulluar axhallarët e mi, po ashtu edhe rrugën me kubëza betoni e kanë shtruar axhallarët e mi edhe pse babai im i patë propozuar që ta shtrojmë së bashku me asfalt.

Dëshmitari M.B., në seancën për shqyrtim kryesor ka deklaruar se është e vërtetë se unë me A. jam marrë vesh që t'ia kryej ndërtimin e garazhës me sistemin ndërtimor me çelësa në dorë, para fillimit të punëve unë dhe A. kemi shikuar vendin ku duhet fillojnë punimet, punët kanë filluar me datë 24 apo 25 tetor të vitit 2014, aty ka qenë një shtëpiak mbikëqyrës i shtëpive të të paditurve dhe ai ka shfaqur brengën se nga pesha e madhe e kamionëve mund të dëmtohen kubëzat e betonit dhe ne e kemi siguruar se për çdo dëmtim të kubëzave të betonit përgjegjësin për kthimin në gjendjen e mëparshme e marrë unë, me ujë dhe rrymë jemi furnizuar prej shtëpisë së parë që është afër garazhave, unë punët e vrazhda në garazhë i kam përfunduar dhe kur kam dashur të fillojë punët tjera mua më është thënë se nuk mund të kalosh më nëpër atë rrugë, punët e vrazhda kanë zgjatur 5 apo 6 javë.

Dëshmitari B.R., në seancën për shqyrtim kryesor ka deklaruar se djali i tezes sime, A. në ngastrën tij në ..., ka filluar ndërtimin e garazhave sipas projektit të bërë nga arkitekti, ne kemi shkuar në vendin e ngjarjes ku kam pasur për të filluar punimet dhe kemi kaluar pa asnjë pengesë dhe të gjitha punët e vrazhda janë kryer pa asnjë pengesë në rrugë, por edhe sa është punuar si arë kjo ngastër I. ia ka dhënë ta punojnë këtë ngastër bujqit e dhe ata bujq kanë kaluar nëpër atë rrugë, kur na është dashur rryma dhe uji, unë kam biseduar me A. dhe ujin dhe rrymë e kam marrë prej shtëpisë së R. dhe punëtori mbikëqyrës i shtëpive nuk ka kundërshtuar asnjëherë dhe na ka ndihmuar.

Dëshmitari M.C., ka deklaruar se ngastra ku janë ndërtuar shtëpitë e R.1 dhe R.2, është blerë para luftës, kur është blerë kjo ngastër prej R.1 dhe R.2, ajo rrugë nuk ka pasur, por R.1 dhe R.2 e kanë hapur atë rrugë për nevojë të shtëpive të tyre, atë rrugë e ka shfrytëzuar edhe I. dhe sa e ka punuar atë, aty pari e ka bartur bereqetin, rrugën me kubëza të betonit dhe dyer të metalta i ka vendosur R., I. nuk e ka punuar tokën, por atë ia ka dhënë ta punojnë disa fqinjë, dhe se a kanë pasur rrugë të përhershme apo vetëm ta punojnë tokën, unë këtë nuk mund ta dijë, ngase nuk kam qenë aty kur ata janë marrë vesh si vëllezër, rruga kontestuese i ka dyert të metalta në fillim të saj ndërsa në fund ka një tel rrethues që mund të jetë 4 apo 5 metra, dhe se I. nuk e ka punuar këtë ngastër, por ia ka dhënë fshatarëve të ..., ti punojnë ndërkaq unë e kam para I. duke kaluar me veturë, por edhe me këmbë duke kaluar.

Dëshmitari S.C., në seancën për shqyrtim kryesor ka deklaruar se unë që dy vite i mbikëqyri shtëpitë e R. dhe R., gjatë këtyre dy viteve nuk e kam parë duke kaluar askënd nëpër rrugën e oborrit të të paditurve, R.1 dhe R.2 janë në Zvicër dhe unë ia mbikëqyri shtëpitë, në fillim të rrugës aty ku lidhet rruga e oborreve me rrugën kryesore regjionale janë dyert të metalta dhe gjithëherë kanë qenë të mbyllura me dry të metalte dhe zinxhirë, një ditë unë e kam parë se dryni ishte hequr dhe dryni ishte hapur dhe në atë moment unë kam qenë në shtëpinë time duke ngrënë bukë dhe menjëherë i kam njoftuar R.1 dhe R.2 përmes telefonit, ata më kanë thënë se ne do ta rregullojmë këtë punë, sa kam mbikëqyrë unë këto dy shtëpi nëpër rrugë nuk ka kaluar as një person, ngase dyert kanë qenë të mbyllura me dry metalik dhe nuk ka mundur të kalojë askush pa hapur drynin, dryni nuk është thyer më herët, teli që ka qenë në fund të rrugës ku ndahet trualli i R.1 me arën e I. ka qenë me shufra metalike në këmbë dhe i ngulitur me bazament betoni dhe gjatë këtyre dy viteve gjithmonë rruga ka qenë e kufizuar me tel, telin e ka vendosur R.1 dhe R.2, dhe në momentin kur unë e kam parë drynin e hequr të dyerve në hyrje të rrugës në atë moment ka qenë i hequr edhe teli, unë e di se pasi që është hequr teli në fund të rrugës dhe është thyer dryni, I. ka filluar me vonë ta ndërtojë një garazhë, por sa ditë më vonë unë nuk mund ta dijë, sa i përket rrymës dhe ujit unë nuk e kam parë I. që e ka marrë rrymën prej R. edhe pse furnizuesit me energji elektrike tek R. janë jashtë shtëpisë, e po ashtu edhe bunari është jashtë shtëpisë, derë në tel në fund të rrugës nuk ka pasur, sa i kam mbikëqyrë shtëpitë e R.1 dhe R.2, unë asnjëherë nuk e kam parë I. të kalojë nëpër këtë rrugë në këmbë apo me veturë, as me traktor që ti punojë këto ngastra, unë e di se I. ia ka dhënë ngastrat e tij fqinjëve që ata ti punojnë, pasi që ai është në Zvicër, mirëpo ata nuk kanë kaluar nëpër këtë rrugë, ngase rruga ka

qenë e mbyllur me dyer të metalta dhe nuk ka mundur të kalojë askush pa i hapur dyert të cilat kanë qenë me kod 1987.

I padituri R.C., i dëgjuar në cilësi të palës së paditur në seancën për shqyrtim kryesor ka deklaruar se ngastrën kadastrale ku kam ndërtuar shtëpitë e kam blerë prej S.B. dhe ajo ngastër është ku është pompa e benzinës dhe menjëherë e kam ndërruar me djalin e axhës Sh., kjo ka ndodhur para luftës, shtëpitë i kemi ndërtuar para luftës ndërkaq rrugën me kocka e kemi shtruar pas luftës, po ashtu edhe murin dhe telin në fund të rrugës i kam bërë pas luftës, vëllau im I., një arë e ka blerë para luftës dhe dy tjera pas luftës dhe vonë unë kam biseduar me vëllaun tim I. dhe i kam thënë a e lejmë rrugën skaj me skaj prej rrugës kryesore nëpër truallin tim dhe të R., por edhe në arën e I. dhe këtë ta bëjmë vëllazërisht, mirëpo ai më ka thënë se anën e epërme ti ski çka kërkon ndërkaq unë në truallin tëndë nuk do të kërkoj asgjë, sepse unë nuk e kam kufizuar fundin e rrugës me mure por me telë, arsye ka qenë se e kam pasur në Pazar edhe arën e S.B. që ta blejë dhe i kam dhënë 90 Euro për metër, por ai nuk ma ka shitur dhe aty ka ndërtuar shtëpinë dhe kjo ka qenë arsye se pse unë nuk e kam rrethuar me murë rrugën në fund të saj, ngase dëshira ka qenë që ta blejë edhe arën e S., dhe është e vërtetë se në muajin dhjetor të vitit të kaluar, A. e ka thirrë B. në telefon dhe ia ka kërkuar kodin e drynit të dyerve, dhe B. ia ka dhënë dhe pas dy tri ditëve mbikëqyrësi i shtëpive tona S., na ka njoftuar se dyert janë hapur dhe dryni është hequr, dhe unë me datë 24 apo 25 dhjetor të vitit të kaluar, kam ardhur në pushim, se vëllai im I. e ka blerë një ngastër që është në kufi me oborrin tim para se unë të ndërtoj shtëpinë dhe atë unë ia kam bërë pazar, me ujë dhe rrymë është furnizuar prej shtëpisë sime, por pa leje dhe dijeninë time, se vëllau im I., kurrë nuk ka kaluar nëpër atë rrugë as me veturë e as me traktor për të shkuar tek arat e tij dhe se në posedim të kësaj rruge kemi qenë vetëm unë dhe vëllau im R. dhe askush tjetër.

Nga çertifikata e pronës nr.3033/14, vërtetohet se rruga tani kontestues është rrugë private e regjistruar si rrugë private me bashkëpronar të paditurit dhe atë e ndarë prej ngastrave – oborreve të të paditurve, pra të paditurit e kanë regjistruar të drejtën e pronësisë në këtë rrugë si bashkëpronar në pjesën prej 1/2 , pra rruga është ngastër e veçantë me numër të veçantë e regjistruar si rrugë.

Nga provat e administruara gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi I.C., nuk ka qenë në posedim të kësaj rruge gjegjësisht të rrugës e regjistruar me numër 2686/3, dhe se në posedim të saj kanë qenë të paditurit të cilët këtë rrugë e kanë shfrytëzuar për hyrje dhe dalje në oborrin dhe shtëpitë e tyre.

Rruga kontestuese për të cilën është kërkuar mbrojtje gjyqësore prej paditësit nga shikimi i gjykatës në vendin e ngjarjes është vërtetuar se ajo është e rrethuar në të gjitha anët, në hyrje ka dyert metalike me dry dhe kod për gjatë saj në pjesën jugore është e rrethuar me rrethojë metalike dhe shtylla të metalta për gjatë tërë gjatësisë, ndërkaq në fund të rrugës në perëndim të saj është e thurur me tel, me shtylla të metalta të vendosura dhe përforcuar me tokë me material betoni, ndërkaq në anën veriore me shtëpitë e të paditurve, pra nga konfiguracioni i rrugës dhe

kufizimi i saj vërtetohet se vetëm të paditurit kanë qenë në posedim të saj dhe jo paditësi, pra ajo rrugë është rrugë private e shtëpive të të paditurve e cila është e ndarë prej ngastrës së paditësit me tel rrethues prej metali dhe shtylla metalike, pra nga kjo vërtetohet se këtë rrugë e kanë shfrytëzuar vetëm të paditurit dhe jo paditësi.

Gjykata i ka analizuar edhe deklaratat e dëshmitarëve M.C., A.C., M.B., B.R., por deklaratave të tyre nuk i shprehu besimin nga arsyeja se ata nuk arritën të vërtetojnë para gjykatës në mënyrë bindëse se paditësi I.C., ka qenë në posedim të kësaj rruge dhe e ka shfrytëzuar pa ndërprerë dhe atë në posedim të saj ta kenë penguar të paditurit, pra dëshmitarët M.B. dhe B.R., vetëm treguan si projektues dhe mbikëqyrës të punëve, kanë kaluar nëpër atë rrugë për të shkuar për tek ngastra e paditësit, ku kanë filluar një garazhë dhe e kanë ndërtuar me material të vrazhda, por nuk treguan se si ka hyrë në posedim të kësaj paditësi, a e ka shfrytëzuar më herët duke kaluar aty pari me traktorë, veturë apo diçka tjetër, por se treguan kur ata kanë kaluar në atë ngastër e ndërkaq sa i përket dëshmitarit M.C., gjykata nuk ia shprehu besimin deklaratës së dëshmitarit nga arsyeja se ai ishte kontradiktor në deklaratën e tij, diku thoshte se kur i ka punuar ngastrat I., ai ka kaluar nëpër këtë rrugë, ndërkaq diku thoshte se I. nuk i ka punuar këto ngastra, por ia ka dhënë fqinjëve për ti punuar, pasi që ai është në Zvicër dhe fqinjët herë kanë kaluar nëpër këtë rrugë herë nëpër ara tjera për ti punuar ngastrat e Isetit, e po ashtu kur të merret parasysh gjendja faktike në teren, ekzistimi i dyerve të metalta me dry dhe kod, teli rrethues në fund të rrugës ku kufizohet me ngastrën e paditësit, nënkuptojnë faktin se nuk ka mundur të hyjë askush nëpër atë rrugë përveç të paditurve apo kalimi nëpër atë rrugë me leje të të paditurve përmes dhënies së kodit të drynit.

Po ashtu edhe deklarata e dëshmitarit A.C., për gjykatën nuk u murrë shumë objektive, pasi që ngastra kadastrale e paditësit është e ndarë prej truallit dhe rrugës së të paditurve, dhe edhe trualli edhe rruga janë të rrethuara me dyer metalike dhe tel në fund të rrugës, çka mundësia për shfrytëzim prej personave tjerë përveç të paditure është e pa mundur.

Gjykata në rastin konkret besimin i shpreh deklaratës së dëshmitarit S.C., ngase i njëjti tregoj se si është hequr dryni, si janë hapur dyert dhe se kush ka qenë në posedim të rrugës dhe sipas tij, dy vite sa ka qenë ai mbikëqyrës i shtëpive deri sa nuk është filluar garazha së ndërtuari, në posedim kanë qenë të paditurit dhe se paditësi nuk ka kaluar asnjëherë nëpër atë rrugë as me veturë, traktorë dhe me mjete tjera.

Nga faktet e vërtetuar gjykata në mënyrë të kjartë ka vërtetuar faktin se në posedim të rrugës kanë qenë të paditurit R.1 dhe R.C., dhe se ata këtë rrugë e kanë shfrytëzuar për hyrje dhe dalje në trojet dhe shtëpitë e tyre, e kanë shtruar me kubëza betoni, e kanë rrethuar dhe e kanë mirëmbajtur, prandaj ata janë posedues të kësaj rruge dhe jo paditësi dhe se paditësi nuk e ka krijuar pushtetin faktik mbi atë rrugë me marrëveshje me të paditurit, ashtu siç e parasheh Ligji për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, pra në rastin konkret paditësi nuk ka pasur kurrfarë marrëveshje me poseduesit gjegjësisht pronarët e rrugës për kalim nëpër rrugë.

Vetë fakti i ekzistimit të dyerve metalike me kod për hapjen e tyre në fillim të rrugës nënkupton faktin në posedim të rrugës kanë qenë vetëm të paditurit që i kanë shtëpitë aty dhe se posedues nuk ka qenë fare paditësi.

Fakti se djali të paditësit ia ka dhënë kodin për hapjen e dyerve, djali i të paditurit Ramadan, pa i treguar arsyen pse e kërkon kodin për hapjen e dyerve metalike, vërteton faktin se në posedim të kësaj rruge kanë qenë vetëm të paditurit dhe jo paditësi, e po ashtu edhe mbyllja e rrugës në fund me tel dhe shtylla të metalta të ngulura në tokë dhe përforcuara me material betoni, vërteton se ajo rrugë nuk ka pasur dalje dhe aty ka qenë fundi i rrugës dhe atë nuk e ka shfrytëzuar gjegjësisht nuk ka qenë në posedim paditësi, por të paditurit.

Qëndron fakti se paditësi, se me ta marrë kodin ka hapur dyert dhe brenda një kohë të shkurtër në ngastrën e tij ka filluar një garazhë me material të vrazhdë, duke e bartur materialin nëpër këtë rrugë, por pa pëlqimin e të paditurve, e po ashtu edhe rrymën edhe ujin e ka marrë prej shtëpisë së paditurit R. pa pëlqimin e tij, ngase ai ka qenë në Zvicër, dhe pusin e ujit dhe rrjetin elektrik – furnizues e ka pasur jashtë shtëpisë, pra nuk mundet në rastin konkret paditësi të thirret se ka qenë në posedim të kësaj rruge nga fakti se ai e ka bartur materialin ndërtimor nëpër këtë rrugë, pa prezencën dhe pëlqimin e të paditurve, duke shfrytëzuar mungesën e tyre në shtëpitë e tyre nga arsyeja se ata jetojnë në Zvicër, dhe me ta mësuar këtë fakte të paditurit si posedues kanë pasur të drejtë ta mbrojnë pronën e tyre.

Me Ligjin për Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore nr.03/L-154, sa i përket posedimit ky ligj në mënyrë shprehimore ka paraparë se cili quhet person i cili është posedues dhe atë dispozita e nenit 103 të këtij ligji shprehimisht e përcakton se personi i cili ushtron pushtet faktik mbi një send është posedues i drejtpërdrejtë, pra posedues të drejtpërdrejtë në rastin konkret janë vetëm të paditurit, ngase ata kanë ushtruar pushtet faktik mbi rrugën e kanë të rrethuar atë me rrethojë metalike me dyer si në fillim të saj e në fund me tel rrethues me shtylla të metalta të ngulura në beton dhe të palëvizshme, pra fakti se rruga ka qenë e mbyllur me tel rrethues, por edhe me dyer metalike në fillim e nënkupton se pushtetin faktik mbi atë rrugë e kanë pasur të paditurit dhe jo paditësi.

Pra, në posedimin e kësaj rruge nuk ka qenë paditësi, por të paditurit dhe se me largimin e telit dhe nxjerrjen e shtyllave metalike prej betoni, paditësi i ka penguar të paditurit në posedim të rrugës, ngase pa pëlqimin e tyre i ka hapur dhe e ka mënjanuar telin.

Nga deklarata e dëshmitarit S.C., gjykata vërtetojë faktin se gjatë vitit 2013 dhe 2014, para se të fillojë garazhën paditësi, dëshmitari si mbikëqyrës së shtëpive të të paditurve nuk e ka parë asnjëherë duke kaluar paditësin me traktorë, veturë apo diçka tjetër nëpër këtë rrugë.

Pra, gjykata në rastin konkret vëren se paditësi I.C., nuk ka qenë fare në posedim të kësaj rruge, por në posedim të rrugës private të regjistruar në drejtorin përkatës në Kamenicë si rrugë private në emër të të paditurve, të paditurit e kanë shfrytëzuar atë dhe e kanë rrethuar në të gjitha anët rrugën për ta shfrytëzuar vetëm ata ndërkaq ngastra e paditësit e cila kufizohet me ngastrën

e të paditurve, është arë dhe nuk ka pasur dalje në rrugën kryesore nëpër këtë rrugë private, kjo vërtetohet si nga fakti i ekzistimit të dyerve të metalta të oborrit të mbyllura me dry, e po ashtu edhe rrethimi i tërësishme i rrugës në të gjitha anët me tel, me shtylla metalike të përforcuara në tokë me beton, pra paditësi sipas kësaj gjykate nuk ka krijuar pushtetin faktik ashtu siç e kërkon Ligji mbi Pronësinë dhe të Drejtat Tjera Sendore, por edhe nuk e ka shfrytëzuar atë rrugë dhe për gjykatën hapja dhe heqja e telit me forcë në fund të rrugës nga paditësi, nuk nënkuptojnë që ai ka hyrë në posedim të kësaj rruge, ngase për të qenë në posedim poseduesi duhet të ushtrojë pushtet faktik mbi sendin, pra të jetë i tij sendi apo ta mbajë si të tij, dhe ta ushtrojë pushtetin faktik mbi sendin e që në rastin konkret paditësi nuk e ka bërë, por këtë pushtet faktik e kanë pasur të paditurit.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata ia ka pranuar pjesërisht shpenzimet të paditurve sa i përket shpenzimeve për pjesëmarrje në seanca gjyqësore dhe atë tri seanca shumë prej nga 202.50 Euro për seancë si dhe për përgjigje në padi shumë prej 200.50 Euro ndërkaq nuk ia pranojë shpenzimet për shikimin e shkresave të lëndës për pjesëmarrje në një seancë gjyqësore, ngase sipas autorizimit zëvendësues personi që i ka përfaqësuar të paditurit nuk është avokat dhe sipas T.A-së nuk i takojnë shpenzimet për përfaqësim në seancë (seanca për këqyrjen e vendit të ngjarjes).

Nga të cekurat më lartë gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJILAN- DEGA NË KAMENICË
Departamenti i Përgjithshëm- Divizioni Civil
Më 31.07.2015, C.nr.220/2014

Sekretari juridik,
Ardian Sermahaj,d.v.

Gj y q t a r i,
Burim Shala,d.v.

Këshilla Juridike: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të tij, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.

